



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT

Nr. prot.

Tiranë, më, .____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM TE KONTRATES ME OBJEKT PROKURIMI
“SHËRBIME PASTRIMI TË KOSHAVE DEKORATIVE”**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIME PASTRIMI TË KOSHAVE DEKORATIVE”
për nevojat e DPPGJ per vitin 2024.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT FPP)
(CPV): 50000000-5

VLERA E FONDIT LIMIT: 15 003 315.2 (pesëmbëdhjetë milion e tremijë e treqind e pesëmbëdhjetë pik dy) leke pa TVSH me burim financimi buxhetin afati mesëm 3 vjeçar 2024-2026

I mbajtur sot më date **21.08.2024**, në DPPGJ – Tirane, në prani të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit të ngritur me Urdhër të Titullarit të AK, për miratimin e dokumentave të tenderit «Tender i hapur», Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, lloji i kontratës shërbim **me afat ekzekutimi 12 muaj nga data e lidhjes se kontratës** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim nga specialistet e fushes për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

a) Pastrimi i mbeturinave të çastit nga koshat dekorative dhe transporti, ngarkimi e shkarkimi i tyre do të realizohet sipas grafikut të përcaktuar si më poshtë.

b) Pastrimi i kontenerëve do të realizohet sipas grafikut të përcaktuar si më poshtë e pasqyruar në mënyrë tabelare:

1	2	3	3	4	5	6	7
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia/Kosha	Intervali /herë	Koha /Ditë	Çmimi Njësi	Çmimi Total
1	Pastrimi i mbeturinave të çastit nga koshat dekorative dhe transporti, ngarkimi e shkarkimi i tyre.	cope	1072	2	365		
2	Dezinfektim kosha dekorative	M2	2358.4	1	48		
3	Pastrimi dizinfektimi i kontenereve sipas PGM.	cope	43	1	144		
			Çmimi Neto)				
			TVSH (%)				
			Çmimi Total				

Afati i kryerjes së shërbimit: 12 (dymbëdhjete) muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Zonat ku do të kryhet shërbimi:

Grafiku i punës:

- Turni i parë fillon në orën 6:00 deri 13.00 dhe itinerarin është si mëposhtë vijon :

Njësia 1, Njësia 2, Njësia 3, Njësia 4, Njësia 5, Njësia 6, Njësia 7, Njësia 8, Njësia 9, Njësia 10, Njësia 11.

Ky grafik do të zbatohet çdo ditë për 7 ditë të javë

- Turni dytë fillon në orën 13:00 deri 19.00 dhe itinerarin është si mëposhtë vijon

Njësia 1, Njësia 2, Njësia 3, Njësia 4, Njësia 5, Njësia 6, Njësia 7, Njësia 8, Njësia 9, Njësia 10, Njësia 11.

Ky grafik do të zbatohet çdo ditë për 7 ditë të javë

- Puna fillon në orën 6:00 deri në përfundim të evadimit të mbeturinave dhe grafiku është si mëposhtë vijon.


Ky grafik do të zbatohet 3 herë në javë.

- Puna fillon në orën 6:00 deri në përfundim të evadimit të mbeturinave dhe grafiku është si mëposhtë vijon.

Grumbullimi dhe Transportimi i Mbetjeve Urbane

- Gurre e madhe 12 Kontenierë
- Gurre e vogel 4 Kontenierë
- Tagan 11 Kontenierë
- Zaranike e Poshtme 8 Kontenierë
- Qeha (Lumi Erzen) 8 Konteniere

- **Ky grafik do të zbatohet 3 herë në javë.**
- Për volumet e punimeve Autoriteti kontratues ka parashikuar paraprakisht të gjitha pikat e grumbullimit të mbetjeve për vendndodhjen PGM (pika të grumbullimit të mbetjeve) me volum 1.7 m3.
- Operatori i shërbimit duhet të kryejë shërbimin e plotë të parashikuar në metodologji 129 zbrazje kontenierësh/javë, për zonën rurale nga të cilët 43 kontenierë do të shërbejnë për procesin e grumbullimit të mbetjeve për zonën rurale (Petrelë) sipas listës së shpërndarjes sa më sipër.
- Këto janë paraqitur në listën e pikave të vendosjes së kontenierëve për grumbullimin e mbetjeve në zonën rurale (Petrelë) dhe sipas hartës





- Specifikime teknike dhe metodologjia Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në: a. Zbrazjen e • 43 kontenierëve me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar, mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 10 m nga çdo kontenier, pastrimin e sipërfaqes prej 30 m² rreth çdo pike grumbullimi, si dhe rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar.

Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike për mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur. Më pas makinat teknologjike kryejnë transportin e mbeturinave në fushën e depozitimit të tyre. Duhet të bëhet dezinfektimi periodik, pas zbrazjes së çdo kontenieri, me pluhur gëlqereje me 5% përmbajtje klori, brenda çdo kontenieri ose duke përdorur sistemin e dezinfektimit që duhet ta ketë çdo makinë teknologjike, duke përdorur të tretur lëndën e pluhurit të gëlqeres me 5% përmbajtje klori.

- Plani i vendosjes së kontenierëve dhe grafikët e punimeve
 - Autoriteti kontratues ka paraqitur pikat ekzakte të grumbullimit të mbetjeve të ngurta urbane, dhe numrin e kontenierëve për secilën pikë, në të gjithë zonën e kërkuar për shërbimin.
 - Operatori i shërbimit është i detyruar të zbatojë planin fillestar të pikave dhe kontenierëve të kërkuar (bashkëngjitur specifikimeve teknike) si dhe çdo ndryshim të tyre përgjatë kohës së zbatimit të kësaj kontrate. Ky plan mund të ndryshojë gjatë kohës së zbatimit të kontratës me propozim të operatorit të shërbimit ose nga Autoriteti kontratues sipas nevojave për përmirësimin e shërbimit dhe mirë organizimit të tij, ose si rezultat i ndryshimeve që mund të ndodhin në infrastrukturë gjithmonë pas kërkesës së njëres palë dhe bëhen të zbatueshme pas miratimit të Autoritetit kontratues.

- Grafikët e punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, pregatiten nga operatori i shërbimit dhe miratohen nga Autoriteti kontratues. Këta grafikë mund të pësojnë ndryshime sa herë lind e nevojshme.
- Në grafikun e punimeve duhet të përcaktohen saktë:

1. Ditët e operimit në secilën pikë kontenerësh.
2. Llojin dhe intenerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
3. Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh. Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit.
4. Autoritetit kontratues ka të drejtë të inspektojë në çdo kohë dhe në përfundim vendet e grumbullimit të mbeturinave për të parë kryerjen e shërbimeve të sipër përmendura, respektimin e standarteve të kërkuara, rregullave dhe cilësisë së kërkuar dhe për të vendosur ndalesa, penalitete dhe gjopa për mospërbushjen e tyre.

➤ Rregulla për tu zbatuar :

- Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, operatori i shërbimit duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin kontraktor.
- Në rastet kur mbetjet hidhen në mënyrë të përsëritur operatori i shërbimit ka të drejtë të kërkojë miratimin e vendosjes së kontenerëve dhe përfshirjen në grafikun e punimeve.

- Mjetet dhe pajisjet Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) këto mjete dhe pajisje: 1 Makinë e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, për realizimin e kontratës, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10-12 ton, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2010. Kjo makineri teknologjike që do përdoret për zbatimin e kësaj kontrate duhet të jetë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike tek ‘Kriteret Teknike’.

➤ **Rregulla të tjera për mjetet dhe pajisjet:**

a. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohen në çdo kohë nga Autoriteti kontratues për gjëndjen e gadishmërisë dhe inventarizimin e tyre.

b. Të gjitha automjetet të cilat do të përdoren, duhet të jenë të identifikuara nga Autoriteti kontratues. Ato duhet të mbahen në gjëndje të pastër dhe të rregullt.

Shperndarja e Koshave

Nr.	Objekti	Sasia (cope)
	Njësia Administrative Nr.1	
1	Shkolla "1 Maji"	5
2	Shkolla "Ali Demi"	1
3	Kopshti nr.24	2
4	Rruga "Konti Leopold Bertold"	3
5	Lulishte "Ali Demi"	9
6	Rruga "Ali Demi"	10
7	Rruga "Ali Shefqeti"	10
8	Çerdhja nr.60	2
9	Çerdhja nr.62	2
10	Shkolla "Marie Logoreci"	8
11	Shkolla "Androkli Kostallari"	6
12	Rruga "Bajo Topulli"	8
13	Blloku ne rrugen "Gani Domi"	1
14	Shkolla "Abdullah Keta"	1
15	Shkolla "Kushtrimi I Lirise"	1
16	Kopshti nr.60	1
17	SHUMA	70
	Njësia Administrative Nr.2	
19	Sheshi "Avni Rustemi"	1
20	Rruga "Elbasanit"	7
21	Rruga "Papa Gjon Pali II	5
22	Rruga "Gjergj Filipi "	2
23	Lulishtja pas Amb. Amerikane	3
24	Lulishtje tek Pallati Kong.	18
25	Rruga "Petronin Luarasi"	6
26	Njesia adm. 1 dhe 2	5

27	Shkolla "Isamil Qemali"	6
28	Terminali i autobuzave te juglindjes	8
29	Sauk i vjeter	4
30	Lulishte Parlamenti	17
31	Rruga "Murat Toptani"	4
32	Lulishtja mbrapa pallatit te Kultures	13
33	Rruga "Luigj Gurakuqi"	1
34	Shkolla "Kosova "	7
35	Kryeministria	6
36	Kopshti 41	4
37	Kendi Lojgrave "7 Xhuxhat"	20
38	Bulevardi "Deshmoret"	12
39	Shkolla "Mihal Grameno"	4
40	Shtepia e Femijeve "Z. Hallulli"	4
41	Tek Unaza tek "Kisha Katolike" ,BKT, Bulevardi 'Gjergj Fishat" pran karburant "Elda"	5
42	Liceu Artistik	2
43	Shkolla "Mustafa Gerblleshi"	2
44	Xhorxh W Bush	2
45	Shkolla "Hoxha Tahsim"	4
46	Rruga "28 Nentori"	7
47	Lulishte Sahati	4
48	Lulishte Galeri Reja	4
49	"Parlamenti"	8
50	"TOB"	8
51	Blv "Zhan D'Ark"	4
52	SHUMA	207
53	Njësia Administrative Nr.3	
54	Rruga "Kongresi Manastirit"	4
55	Gjimnazi "Andon Z. Çajupi"	11
56	Kopshti nr.22	5
57	Kopshti nr.20	7

58	Lulishtja tek ish tregu fruta perime (Varri) Bamit	4
59	Kopshti nr. 1	5
60	Rruga e "Xhanfize Keko "	8
61	Shkolla "Niket Dardani"	5
62	Sheshi "Shtraus"	2
63	Lulishte "Sytki Çiço"	5
64	Lulishte "Endi Keko"	5
65	Shkolla "Mrekullia"	1
66	Fresku	1
67	Shkolla "Xhezmi Delli"	4
68	Çerdhja nr.56	5
69	Shkolla "Kongresi I Lushnjes"	1
70	Shkolla "Hasan Prishtina"	1
71	Kopshti Nr.60	1
72	SHUMA	75
73	Njësia Administrative Nr.4	
74	Shkolla "Bajram Curri"	5
75	Shkolla "Ramazan Jarani"	5
76	Kopshti nr.39	2
77	Rr. Dibres seg. Farmacia 10- Rr.Ura	4
78	Rruga "Niko Avrami"	4
79	Te Katrori (Alias)	15
80	Rruga "Andrea Mano"	4
81	Poliklinika nr 10	3
82	Rruga "Grigor Peliçeu"	3
83	Shkolla "Gjon Buzuku"	4
84	Shkolla "Ardjan Klosi"	5
85	Lulishte Ora News	3
86	Rruga "Njazim Meka"	4
87	Kopshti nr.51	5
88	Rruga "Aleksander Moisiu"	4
89	Xhamia Xhura	6

90	Shkolla "Eqerem Cabej	1
91	Shkolla "Pal Engjelli"	1
92	Kopshti Nr.25/A	1
93	Kopshti Nr.27/A	1
94	Kopshti Nr.55	1
95	SHUMA	81
96	Njësia Administrative Nr.5	
97	Lulishte Presidenca	4
98	Kuvendi Shqiperise	5
99	Lul."Qemal Stafa" kosh betoni	6
100	Lul."Qemal Stafa" kosh te vegjel	4
101	Kopshti nr.42	6
102	Shkolla 'Edit Durham'	10
103	Rruga "Brigada e VIII	1
104	Shkolla 'Deshmoret e Lirise'	3
105	Shkolla "At Zef Pellumbi"	4
106	Shkolla "Emin Duraku"	4
107	Shkolla "Petronin Luarasi"	1
108	Rruga e Kosovarve	4
109	Lulishte St. Dinamo	36
110	Shkolla "Vasil Shanto"	4
111	Shkolla "Besim Sykja"	6
112	Kendi lojrave Rr."M.Qosja"	2
113	Lulishte "Komuna Parisit"	2
114	Rruga "Grigor Heba"	2
115	Rruga "Irfan Tomini"	6
116	Rruga "Ibrahim Rugova"	6
117	Shkolla "26 Nentori "	1
118	Lulishte "Irfan Tomini"	1
119	Konvikti "Hoteleri Turizem"	3
120	Lulishte ne bllokun qe kufizohet nga rruget "Irfan Tomini"- "Frang Bardhi"- "Rruga Kavajes"- " Bulevardi Bajram Curri"	6

121	Rruga "Ismail Qemali"	2
122	Parking Tirana (diga liqenit)	2
123	Lulishte Cajupi	11
124	Kopeshti nr.31	4
125	Kopeshti Nr.52	6
126	SHUMA	152
127	Njësia Administrative Nr.6	
128	Lulishte "Llazi Miho"	10
129	Sheshi "Garibaldi"	4
130	Lulishte "Tanush Frasheri"	2
131	Rruga "Llambi Bonata"	6
132	Shkolla "Lasgush Poradeci"	5
133	Shkolla "Betim Muço"	5
134	Lulishte "Ali Kelmendi"	3
135	SHUMA	35
136	Njësia Administrative Nr.7	
137	Rruga "Sali Butka"	5
138	Rruga "Shefqet Musaraj"	2
139	Rruga "Dritan Hoxha"	12
140	Fusha Aviacionit	17
141	Rruga "Myslym Shyri"	7
142	Rruga "Muamet Gjollesha"	1
143	Lulishte ne Rr."Vellezrit Manastirli"	4
144	Rruga "Ana Komena"	2
145	Rruga "Sander Prosi"	2
146	Shkolla "Naim Frasheri"	5
147	Shkolla "Dhora Leka"	7
148	Sherbimi Permbarimore Gjyqesore	3
149	Kopshti nr.17	4
150	Rruga e "Kavajës"	7
151	Shkolla "Arben Broci"	1
152	Shkolla "Gustav Myer"	1
153	Kopshti Nr.26	1

154	Kopshti Xixellonja	1
155	SHUMA	82
156	Njësia Administrative Nr.8	
157	Rruga "5 Maji"	4
158	Shkolla "Skender Çaçi"	7
159	Shkolla "Misto Mami"	7
160	Rruga "Ferit Xhajko"	8
161	Rruga e "Dibres"	20
162	Blloku pall.rruga Qelqit"	3
163	SHUMA	49
164	Njësia Administrative Nr.9	
165	Shkolla "7 Marsi"	6
166	Rruga "Haxhi Hysendelliu"	6
167	Kendi lojrave "Petro Marku"	4
168	Lulishte ne rrugen "Hasan Ceka"	3
169	Rruga "Don Mark Dushi"	4
170	Skolla "Qazim Turdiu"	5
171	Rruga "Don Bosko"	2
172	Rruga "Asim Vokshi"	8
173	Rruga "Reshat Petrela"	3
174	Rruga "Myrteza Topi"	8
175	Shkolla "Jeronin De Rada"	4
176	Bulevardi I Ri	35
177	Shkolla "Hasan Vogli"	6
178	SHUMA	94
179	Njësia Administrative Nr.10	
180	Shkolla "Kristoforidhi"	4
181	Shkolla "Arben Broci"	2
182	Lulishte "Adem Jashari"	3
183	Lulishte pas gjimnazit "Qemal Stafa"	5
184	Rruga Skenderbeg (blloku i Ambasadave)	4

185	Rruga e "Durresit"	12
186	Rruga e "Kavajes"	4
187	Rruga "Sami Frasheri"	2
188	Shkolla 'Dora Distria'	7
189	Gjimnazi "Qemal Stafa"	3
190	Partia Socialiste,Posta Qendrore	20
191	Sheshi "Skenderbej"	37
192	Muzeu Gjetheve	4
193	Ministria e Arsimit	4
194	"Dollari"	3
195	"Ibrahim Rrugova"	6
196	Bloku ne rrugen"Edit Durhan"	2
197	Bloku pall."Sheshi Bukureshti"	1
198	Rruga "Bogdaneve"	8
199	SHUMA	131
200	Njësia Administrative Nr.11	
201	Rruga "Lord Bajron"	1
202	Rruga "Pandi Dardha"	1
203	Lulishte ne Rruga "Don Bosko"	5
204	Lulishte Rr. "Dritan Hoxha"	3
205	Rruga "Kastriotet"	8
206	Universitetit Bujqesore	2
207	Shkolla "Aleks Buda"	7
208	Shkolla "Kol Jakova'	12
209	Shkolla "Isa Boletini"	5
210	Terminali I autobuzave inter urban	10
211	Kopeshti koder Kamez	2
212	Rruga "Don Bosko"	1
213	Shkolla "Ahmet Gashi"	1
214	Shkolla "28 Nentori"	1
215	Shkolla "Skender Luarasi	1
216	Shkolla "Gjergj Fishta"	1
217	Kopshti Nr.14	1

218	Kopshti Nr.28	1
219	Kopshti Bregu Lumit	1
220	Kopshti Nr.11	1
221	Kopshti Nr.30	1
222	SHUMA	66
223	Lumi "Lana"	
224	Lumi "Lana"	30
225	SHUMA	30
226	Kontenier	
227	Gurre e madhe	12
228	Gurre e vogel	4
229	Tagan	11
230	Zaranike e poshme	8
231	Qeha (Lumi Erzen)	8
232	SHUMA	43
233	Shuma totale e koshave Dekorative	1072

Shpërndarja e Kontenierëve:

- Gurre e madhe 12 Kontenierë
- Gurre e vogel 4 Kontenierë
- Tagan 11 Kontenierë
- Zaranike e Poshtme 8 Kontenierë
- Qeha (Lumi Erzen) 8 Kontenierë

Ne total 43 konteniere

Per objektin ne reference.

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedurë prokurimi, është mbështetur tek grupi i punës i ngritur me urdhër Nr.440 Prot datën 16.08.2024. për hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve të vecanta teknike, të procedurës ne reference.

Data e hapjes së ofertave planifikuar date 06.09.2024 ora: 12:00.

- www.app.gov.al

- *Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip.*
- *Dokumentat pa pagesë.*

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e kualifikimit, të cilat u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi/Kualifikimit, janë të pa ndryshueshme nga ato të miratuar nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (2% te vleres se fondit limit)*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Krieteve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim sipas shtojcës 9*)

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit ushtrimore (2021,2022,2023) nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare vjetore e të cilës të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës** se parashikuar te kontrates.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 1 dhe pika 2 germa ”c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet

deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe vërtetimin. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të të ardhurat", i ndryshuar, neni 29.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) 'Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', si dhe pika 6 e këtij neni: 'Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin'.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: **(2021, 2022, 2023)** të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe bilancet.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin Nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:* ”c) *shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:*

- i) *totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;*
- ii) *ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;*
- iii) *iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) ‘Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, si dhe pika 6 e këtij neni: ‘Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin’

Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik, janë argumentuar nga grupi i punës i ngritur me Urdher Nr. 440 Prot date 16.08.2024, specialistet e fushes nisur nga natyra dhe permasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i levrimit, fushes se veprimtarise se institucionit, konkretisht si vijon:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më vogël se 40 % e vlerës së perlllogaritur të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, **ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara,**
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë **ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së perlllogaritur të kontratës**, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e kërkuar është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Plotesimi i njerit nga kushtet e mesiperme e ben oferten te kualifikueshme

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) ‘Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, si dhe pika 6 e këtij neni: ‘Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari

dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin’.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin teknik i cili duhet te kete nje eksperience pune **jo me pak se 5 vjet ne fushën e ofrimit te shërbimit të pastrimit**, e vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit. Shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune (përkatëse)
- b) Diplomë
- c) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” : *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomik për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

Në VKM-në nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, Kreu IV “Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajueshmëria me këtë detyrë”, pika 1, ku parashikohet shprehimisht: “Drejtuesi teknik i shoqërisë ;

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 vjet nga diplomimi.

b) Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimin të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

c) Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë rregullohen sipas kontratës individuale të punës.”

Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit me eksperiencë pune të paktën 5 (pesë vjet). Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Duke ju referuar zerave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij, është shumë e rëndësishme për AK kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi. Kriteri i mesipërme për eksperiencën e drejtuesit teknik është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet. Përvoja 5-vjecare lidhet ngushtë me afatin e realizimit të objektit të prokurimit, tregon aftësitë menaxhuese drejtuesit teknik për kontrata afatgjata.

Ekspertët e fushës gjykojnë se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi se ofertuesi disponon staf të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Drejtuesi Teknik i shërbimit të pastrimit është përgjegjës për zbatimin e këtij shërbimi në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Duke ju referuar zërave të preventivit dhe specifikimeve teknike të tij është shumë e rëndësishme për AK, kapaciteti dhe përvoja e mëparshme në punë e drejtuesit teknik të këtij shërbimi që vërtetohen në CV përkatëse të tij.

Duke qenë se ky shërbim do të kryhet për një mjedis të pastër të Bashkisë Tiranë dhe Njësi Administrative sipas zonave të përcaktuara në preventiv, kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor nuk shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme, por garanton këtë të fundit që kontrata do të zbatohet në përputhje me legjislacionin mjedisor në fuqi.

2.3.3 Për të përmbushur kapacitetet teknike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin gjithashtu kontratë pune të vlefshme dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi nga një organizëm i akredituar/licencuar/certifikuar shqiptar ose i huaj për **1(një) ekspert i specializuar për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë** sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”,

“dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” : *Aftësia profesionale e operatorëve ekonomik për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.*

Kërkesa për një punonjës të certifikuar si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” bazohet në kërkesat e Ligjit Nr.10 237, dt 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”

2.3.4. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te vertetojë se disponon kualifikimet e duhura te stafit inxhinierik perkates si me poshte me eksperiencë **pune** per kryerjen e te gjitha sherbimeve siç kërkohet në DST. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacion se ka si të punesuar dhe te regjistruar ne kompanine e tij për të paktën 3 muajt e fundit stafin inxhinierik si më poshtë:

- **1 (një) inxhinier Mjedis**, i cili duhet të jetë i pajisur me çertifikatat si mëposhtë:
 - Çertifikatë për vlerësimin e ndikimit në mjedis.
 - Çertifikatë per menaxhimin e mbetjeve.
 - Çertifikatat duhet të jenë të akredituara nga institucione vendase apo/të huaja dhe/ose/apo nga organizma vendas apo/ose të huaj ndërkombëtarë.
- **1 (një) inxhinier Mekanik** i pajisur me dëshmi aftësie profesionale për aktivitete e autoriparimit (lëshuar nga organizma/institucione kombëtare apo/ose organizma/institucione ndërkombtare të akredituara.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kriteri Operatori ekonomik duhet te paraqese Diplomat/kontratat e punes të vlefshme, librezat e punes cv perkatese, si dhe çertifikatat e kërkuara.

Bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të

